



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2744/1 prot.

Tiranë, më 19.11.2025

Lënda: Mendim mbi një projektligj

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka marrë në shqyrtim shkresën tuaj me nr.4145 Prot., datë 24.10.2025, administruar me tonën me nr.2744 Prot., datë 27.10.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “*“Për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”* (në vijim “*Projektligji*”) si dhe dokumentacionin shoqërues të tij.

Nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve konstatojmë se ky projektligj, ka si qëllim mbrojtjen e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje përmes masave të përshtatshme ligjore dhe politikave të integruara dhe gjithëpërfshirëse. Njëkohësisht, projektligji synon përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me standardet ndërkombëtare si Konventa dhe Direktiva të Bashkimit Evropian, në këtë fushë.

Nisur nga gama e gjerë por dhe natyra delikate e të dhënave personale si dhe kategoria e subjekteve të përfshira në këtë projektligj, respektimi i standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale, përbën një detyrim thelbësor.

Kështu, sa i përket përmbajtjes së dispozitave të Projektligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson se në disa nene është e nevojshme që paragrafët në të cilat përcaktohen dispozita ligjore që lidhen me përpunimin e të dhënave personale, ruajtjen e konfidencialitetit, etj, të rishikohen dhe mirëpërcaktohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vijim, propozojmë të mbahen në konsideratë disa komente dhe sugjerime si më poshtë vijon.

*Në shkronjën d), të pikës 2, të nenit 10, të projektligjit* sugjerojmë që togfjalëshi “ ..ose të dhëna personale të një personi” të zëvendësohet me togfjalëshin “duke përfshirë dhe të dhëna personale të një personi”.

*Pas pikës 8, të nenit 24, të projektligjit* sugjerojmë të shtohet një pikë 9, me këtë përmbajtje: “4. Masat administrative mbi përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale vendosen nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Ky sugjerim vjen për të pasur kohezion dhe referencë të saktë ligjore sa i përket institucioneve të cilat kanë në kompetencë të tyre vendosjen e sanksioneve (*bazuar në ligjet specifike*) duke iu referuar masave mbrojtëse të përcaktuara në nenin 20 të projektligjit, në veçanti shkronjës a), ë) dhe 1) të pikës 2 të këtij neni.

*Shkronja “b”, e pikës 7, të nenit 33, të projektligjit* sugjerojmë të riformulohet me këtë përmbajtje: “b. përcakton rregulla për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

*Në nenin 52,* sugjerojmë të shtohet një pikë 2, me këtë përmbajtje: “2.Regjistri Elektronik Unik krijohet dhe përpunon të dhëna personale në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

*Shkronja b), e pikës 2, në nenin 58, të projektligjit* vërejmë se është përsëritje e pikës 7 e nenit 33, të projektligjit. Në këtë rast sugjerojmë që ky rregullim të qëndrojë në një nga këto nene apo të riformulohet në vlerësimin tuaj.

Në përfundim, sugjerimet e mësipërme synojnë të garantojnë zbatim sa më efektiv të legjislacioneve respektive, duke kontribuar në një kuadër ligjor më të qartë, të qëndrueshëm dhe funksional në përputhje me standardet më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**